
PËRPLASJET IDENTITARE DHE INTEGRIMI EVROPIAN I SHQIPTARËVE THE CLASHES OF IDENTITY AND THE EUROPEAN INTEGRATION OF ALBANIANS

BLERIM BALLA
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, SHQIPËRI
blerim_balla@yahoo.com

AKTET VI, 5: 491 - 494, 2012

PËRMBLEDHJE

Duke i bërë një retrospektivë të shkurtër konceptit evropian të identitetit të shqiptarëve, ajo çfarë mund të themi është se qenia e shqiptarëve një komb evropian është marrë si një fakt i padyshimtë që në fillimet e Rilindjes sonë Kombëtare. Ideologët e veprimtarët e saj e morën të mirëqenë identitetin evropian të shqiptarëve si pjesë integrale të Evropës, edhe pse në të vërtetë identiteti evropian si koncept në Evropën e asaj kohe ishte akoma i pakonsoliduar, por përfshihej në suazën më të gjerë të qytetërimit perëndimor. Lënia jashtë kufijve të shtetit shqiptar e viseve të Kosovës, Çamërisë dhe trojeve shqiptare në Maqedoni ishte një goditje edhe për vetë identitetin e shqiptarëve, sepse copëtonte një nga elementet bazë të këtij identiteti, që ishte njësia territoriale, aq më tepër kur dihet se popullsia e këtyre territoreve kishte dhënë kontributin kryesor në luftën për pavarësinë dhe formimin e kombit shqiptar.

Fjalë çelës: Përplasjet identitare, Shqipëria, integrimi, qytetërimi perëndimor

Key words: Clashes of identity, Albania, integration, Western civilization

Hyrje

Integrimi shqiptar drejt BE-së gjatë këtyre 20 viteve të fundit për fat të keq ka ecur me devijime dhe luhatje të herëpashershme. Procesi i integrimit më mirë se çdo gjë tjetër ka reflektuar situatën politike, sociale dhe ekonomike të shqiptarëve gjatë kësaj periudhe. E rëndësishme është që integrimi drejt Evropës kurrë nuk është kontestuar, por ka qenë busulla drejtuese e elitave tona politiko-shoqërore. Që në protestat e para antikomuniste në fillim të lëvizjeve demokratizuese të dhjetorit '90 parulla lapidare e studentëve ' e duam Shqipërinë si gjithë Evropa' u bë busulla drejtuese e gjithë politikave shtetërore dhe sociale. Anarkia totale që përfshiu shtetin shqiptar pas përmbyesjes së komunizmit, gjendja e terrorit në të cilën jetonin shqiptarët e Kosovës, paqartësia politike në të cilën ndodheshin shqiptarët e Maqedonisë, do të donte që

diskutimet për identitetin e shqiptarëve, konceptet apo faktorët bazë formues të tij të ishin tema luksi në raport me realitetin e vështirë me të cilin ndeshesh e gjithë hapësira mbarëshqiptare.

I. Periudha e Rilindjes Kombëtare

Duke i bërë një retrospektivë të shkurtër konceptit evropian të identitetit të shqiptarëve, ajo çfarë mund të themi është se qenia e shqiptarëve një komb evropian është marrë si një fakt i padyshimtë që në fillimet e Rilindjes sonë Kombëtare. Ideologët e veprimtarët e saj e morën të mirëqenë identitetin evropian të shqiptarëve si pjesë integrale të Evropës, edhe pse në të vërtetë identiteti evropian si koncept në Evropën e asaj kohe ishte akoma i pakonsoliduar, por përfshihej në suazën më të gjerë të qytetërimit perëndimor. Jo më kot si figura qendrore e kombit shqiptar u lartësua

Gjergj Kastrioti Skënderbeu, mbrojtësi i Evropës nga pushtimi osman. Një nga baballarët e kombit shqiptar, Naim Frashëri, e përcaktoi që në fillimet e veprës së tij drejtimin perëndimor të shqiptarëve me sentencën lapidare ‘o drit’ e diturisë që lind tek perëndon...’. Për fat të keq, ëndrra e rilindësve për përfshirjen e shqiptarëve në një shtet të vetëm në trojet e tyre etnike mori një goditje të fortë me copëtimin e gjysmës së territoreve në favor të fqinjëve ballkanikë në Konferencën e Londrës të vitit 1913. Lënia jashtë kufijve të shtetit shqiptar e viseve të Kosovës, Çamërisë dhe trojeve shqiptare në Maqedoni ishte një goditje edhe për vetë identitetin e shqiptarëve, sepse copëtonte një nga elementet bazë të këtij identiteti, që ishte njësisia territoriale, aq më tepër kur dihet se popullsia e këtyre territoreve kishte dhënë kontributin kryesor në luftën për pavarësinë dhe formimin e kombit shqiptar.

II. Periudha midis dy luftërave botërore

Periudha stabilizuese e sundimit të Ahmet Zogut në Shqipëri do të rikthente në vëmendje problemin e identitetit. Rryma e neoshqiptarizmit, e përfaqësuar nga figura të njohura të publicistikës të asaj kohe, si K. Maloki, B. Merxhani, që në vetvete përfaqësonin brezin e parë të postrilindësve, u mor me drejtimin oksidental të shqiptarëve. Duke iu shmangur dhe mbase pa guxuar të shhnin se ç’ishin në të vërtetë shqiptarët, eksponentët më në zë të kësaj rryme bënë thirrje për një rilindje të dytë shqiptare dhe për një ndarje radikale nga ndikimi i periudhës 500-vjeçare të sundimit osman. Oksidentalizimi i shoqërisë shqiptare u bë motoja e tyre bazë, shpeshherë duke anashkaluar këtë histori 500-vjeçare, e cila faktikisht kishte pasur një rol të rëndësishëm në formimin e këtij identiteti. Duke qenë se Oksidenti, d.m.th. Perëndimi kishte triumfuar përfundimisht ndaj Orientit, d.m.th. Lindjes, ata u bënë flamurtarë të qemalizmit, i cili kishte triumfuar dhe sundonte me dorë të hekurt në Republikën Turke të Mustafa Qemalit.

Përpjekja e parë dhe mbase edhe sot me e kualifikuara për një studim të strukturuar të identitetit shqiptar do bëhet në fund të viteve ‘30

nga figura shumëplanëshe e prof. Eqrem Çabejt. Me punimin e tij “Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes” ai jep përcaktimin më të saktë të deritanishëm për këtë problem. Në këtë vepër Çabej thekson se “...ky qëndrim i ndërmjetëm midis perëndimit dhe lindjes, i bashkuar me ruajtjen e ngulur të natyrës së vet etnike, i ka gdhendur Shqipërisë fytyrën e vet të veçantë, e drejtuar gjithmonë nga perëndimi”.(Çabej: 19)

III. Periudha e pas Luftës së dytë deri më 1990

Gjatë viteve të komunizmit më shumë se me identitetin shqiptar sistemi komunist në Shqipëri u mor me “krijimin e njeriut të ri të brumosur me idealet e marksizëm-leninizmit, ndërsa në trojet shqiptare jashtë kufijve shtetërorë ruatja e identitetit u barazua me ekzistencën si popull, duke u përballur me një politike shkombëtarizuese të Jugosllavisë komuniste, por gjithsesi me komponenten serbomadhe dhe sllavofile si ideologji sunduese. Këto kushte do të bëjnë që me gjithë vështirësitë e njohura, shqiptarët në këto vise të shtrëngohen fort tek identiteti i tyre, i cili do të jetë faktori kryesor që do t’i mbajë gjallë. Pas vitit 1967 në shtetin shqiptar, ku feja do të ndalohet rreptësisht, duke qenë të veçantë nga Perëndimi kapitalist, të ndryshëm nga Lindja revizioniste, dhe superiorë ndaj Azisë, Kinës së Mao Ce Dunit, ideologjia shtetërore komuniste mbase edhe pa vetëdije do t’i mëshojë fort identitetit shqiptar mbyllur në suazat e një nacional-komunizmi ortodoks. Mbyllja e të gjitha kanaleve të komuikimit si me Lindjen, ashtu edhe me Perëndimin, do t’i bëjë shqiptarët me shtetin e tyre thjesht shqiptarë të varfër materialisht e shpirtërisht, e për çudi tani edhe të vetmit ateistë në botë, paçka se toleranca fetare e një populli me tri besime kishte qenë mbase kontributi i tij më i madh në historinë e njerëzimit.

IV. Periudha midis viteve 1990 – 1999

Pas rënies së komunizmit, ashtu siç theksojnë njohësit e thellë të Shqipërisë dhe të shqiptarëve, M. Vickers dhe Xhejms Pettifer, shqiptarët u kthyen nga anarkia totale drejt një identiteti ballkanik. Ashtu siç theksuam edhe me sipër,

drejtimi nga Perëndimi, tani më i konsoliduar si nocion evropian, mbeti gjithmonë udhërrëfyes dhe qëllimi që do duhej të arrihej. Për fatin tonë të keq periudha 1997-1998 e shqiptarëve të Shqipërisë, ajo 1998-1999 e shqiptarëve të Kosovës, bëri që përballë integritit dhe identitetit si koncept evropian, shqiptarët të merreshin me diçka më të madhe, pra me luftën për të mbijetuar. Përplasjet e shqiptarëve me shqiptarët në Shqipëri, të shqiptarëve me serbët në Kosovë, të shqiptarëve me shtetin maqedonas të sapo themeluar do të ishin çështje aq të nxehta, sa që do të duhej ndërhyrja e fuqive të mëdha për të krijuar një farë stabiliteti në rajon. Këto përpjekje dhe kjo panoramë kaq tragjike, sidomos për shqiptarët e Shqipërisë, të cilët kacyfateshin me njëri-tjetrin, do të bënte që integrimi si proces dhe si realitet të shtyhej gjithmonë e më larg.

V. Periudha pas çlirimit të Kosovës dhe Marrëveshjes së Ohrit

Çlirimi i Kosovës nga forcat e NATO-s, stabiliteti i shtetit shqiptar pas 1999 dhe Marrëveshja e Ohrit me Maqedoninë do të sillnin një paqe të brishtë në viset shqiptare. Në fillim të shekullit XXI, pa u mbyllur akoma plagët e luftërave në viset shqiptare, shpërthen një debat i madh për identitetin e shqiptarëve nga vetë shqiptarët. Dy nga mendjet më të ndritura të kombit, Rexhep Qosja dhe Ismail Kadareja përfshihen në një debat të ashpër për identitetin, konceptet e faktorët që ndikojnë në formimin e tij. Ashtu si dhe në periudha të ndryshme të historisë sonë, në çdo përplasje qoftë kjo edhe teorike, shqiptarët menjëherë ndahen në llogoret e tyre ekstreme. Ashtu si gjeneralët në luftë me ushtarët e tyre, përkrah këtyre figurave u radhit edhe pjesa tjetër e taborreve pro ose kundër ideve të liderëve respektivë. Nuk mbeti njeri që kishte mundësi të shkruante pa u përfshirë në këtë debat. Rexhep Qosja e përcakton identitetin kombëtar të shqiptarëve si një bashkëveprim të faktorëve ndërveprues që janë, prejardhja e përbashkët, gjuha e përbashkët, kultura e përbashkët dhe historia e përbashkët. (Qosja: 14) Duke u ndalur te historia dhe kultura e përbashkët R. Qosja thekson se sundimi i gjatë

osman normalisht do të lindte gjurmë të thella si në kulturën, ashtu dhe në strukturën shoqërore të shqiptarëve. Duke theksuar ndarjen fetare në Shqipëri dhe, sidomos, kthimin e një pjese të madhe të shqiptarëve në islam, R. Qosja vëren se këta faktorë kanë pasur ndikimin e tyre në etnopsikologjinë dhe në karakterin e shqiptarëve. Në kundërshtim me konceptin e R. Qoses për rolin e historisë dhe të fesë në identitetin tonë I. Kadare e cilëson si klishe të rrezikshme paraqitjen e identitetit të shqiptarëve me ndikime nga Lindja dhe si të papranueshëm sanduicin midis Lindjes dhe Perëndimit ku R. Qosja kërkon t'i vendosë shqiptarët. (Kadare: 55) Megjithëse janë kundërshtarë të rreptë të pseudoidentitetit kosovar dhe njëkohësisht përpjekjeve për cenimin e standardit të gjuhës shqipe dy mendjet më të rëndësishme të shqiptarëve mbeten të pozicionuara rreptë në kundërshtitë e tyre për konceptet e sipërpërmendura.

VI. Shqiptarët mbeten evropianë

Pa guxuar të japim vlerësime për tezat e tyre, ajo çka duam të theksojmë është se I. Kadareja e percepton identitetin si gjenetik e transhendent njëkohësisht. Për I. Kadarenë, shqiptarët kanë qenë dhe do të mbeten evropianë 'të thekur' pavarësisht ndarjeve fetare, historisë 500-vjeçare të sundimit osman dhe peripecive të ndryshme të kombit shqiptar. Megjithëse është i bindur që koncepti i tij 'thith ujë' në realitetin më shumë se ballkanik të shqiptarëve, ku prova më e qartë janë përplasjet politike ndërmjet shqiptarëve në të gjitha trevat e tyre, I. Kadareja me penën e shkrimtarit dhe me mendjen e idealistit përpiqet ta tërheqë kombin e tij drejt idealit ku duhet të shkojë, i bindur se ato fakte të cilat kanë lënë gjurmë te ky ideal që është identiteti evropian i shqiptarëve, do të retushohen rrugës së gjatë të këtij procesi integruar.

Në të kundërt ose më ndryshe R. Qosja më shumë duke përdorur syrin e studiuesit skrupuloz përpiqet që atë realitet shqiptar të përfutur nga ndërveprimi i këtyre faktorëve historikë që përmendëm, ta fokusojë në dritën e së ardhmes. Ky fakt historik për të cilën shqiptarët duhet të jenë të ndërgjegjshëm, duhet marrë si mënyrë

për t'u përmirësuar për ato probleme që shqiptarëve u kanë ndodhur gjatë historisë së tyre. Ajo çka është e veçantë tek këndvështrimi R. Qoses ka të bëjë me fytyrën e veçantë të shqiptarit që na sjell te përcaktimi i E. Çabejt që në vitet '40 të shekullit XX. Profesor R. Qosja i jep një rol të veçantë asaj që A. Davudogllu e quan 'vetëperceptimin qytetrimor', me fjalë të tjera atë çka në të vërtetë ndiejnë dhe që deklarohen qytetarë. (Davutogllu: 17) Për identitetin e shqiptarëve kemi edhe paradokse të tilla si ideja e N. Cleyer tek vepra e saj e fundit "Në fillimet e nacionalizmit shqiptar", ku kjo studiuese thekson se lindja e ndjenjës kombëtare tek shqiptarët e Kosovës është një fenomen që ndodh pas viteve 1991 të shekullit XX, gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë. (Cleyer: 15) Per çudi kjo autore fshin me vetëdije historinë e shqiptarëve të Kosovës që nga Lidhja e shqiptarëve të Prizrenit deri sot. Duke anashkaluar kryengritjet e mëdha të kësaj treve dhe figurat historike që bënë të mundur shpalljen e pavarësisë shqiptare dhe, që për fat të

keq, për gati një shekull u detyruan të jetojnë jashtë truallit të shtetit shqiptar.

Përfundime

Si përfundim mund të themi se me gjithë këto ndryshime për identitetin evropian të shqiptarëve qëllimi për t'u integruar në Evropë gjatë këtyre 20 vjetve kurrë nuk është vënë në dyshim, por ka pasur përkrahjen e çdo shtrese të shoqërisë në të gjitha viset ku jetojnë shqiptarë.

Bibliografia

- CLEYER, Nathaly (2010): *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Botimet Përpjekja, Tiranë.
- ÇABEJ, Eqrem (1994): *Shqiptarët mes Perëndimit dhe Lindjes*, MÇM, Tiranë.
- DAVUDOGLLU, Ahmet: *Vetëperceptimi qytetrimor*, Logos-A, Shkup.
- KADARE, Ismail (2006): *Identiteti evropian i shqiptarëve*, Onufri, Tiranë.
- QOSJA, Rexhep (2006): *Ideologjia e shpërbërjes*, Toena, Tiranë.